



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “K-ing” Sh.P.K. të datës 02.08.2024 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “99 Ndërtimi i ishullit urban Arbëri Pallati i Rinisë” me nr. të prokurimit 616-24-7202-5-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET si e pabazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “K-ing” Sh.P.K. të datës 02.08.2024 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “99 Ndërtimi i ishullit urban Arbëri Pallati i Rinisë” me nr. të prokurimit 616-24-7202-5-1-1.
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “K-ing” Sh.P.K. (tutje “parashtruesi”) me datë 02.04.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “99 Ndërtimi i ishullit urban Arbëri Pallati i Rinisë” me nr. të prokurimit 616-24-7202-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Pretendimi 1 – “Sipas: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale: 2. OE-ik duhet te ofroj dëshmi për stafin profesional dhe atë si vijon : Menaxher i projektit-Inxhinier i diplomuar (ose Master) I ndërtimtarisë-konstruktiv, me min 10 vite përvojë pune pas diplomimit . Të ketë menaxhuar projekte ne fushen e ndertimit ne vlere min 6 milion euro . Dëshmit e kërkuara: 2. CV e nenshkruar nga vete inxhinieri, diploma e noterizuar , kontrata e punës me ofertuesin (kopje e noterizuar ne prezence te punëdhënësit dhe punëmarrësit). Nje liste me kontratat e menaxhuara nga inxhinieri ne vlere min 6 milion euro. Inxhinier i ndërtimtaris Konstruktiv, 10 vite përvoj pune, së pari 10 vite përvoj pune ne rregull ndoshta, per shkak te natyres objektit, dhe diskriminohet kërkesa, të ketë menaxhuar në fushën e ndërtimit mbi 10 milion euro, ku na mbetet besimi i punimeve me kundërolet për një inxhinier të diplomuar të ndërtimtaris, ku ky inxhinier paska aftësi të projektimit pas një studimi dhe deri në diplomim, e jo menxhimin e një kontrate, sa e diskriminoni një profil si inxhinier ju si ZKA, pastaj kërkohen diploma noterizuar, kopje e noterizuar e kontratës së punës, ku përveq që nuk mbroni operatoret ekonomik finaciarishtë për përgaditje të një tenderi, ju edhe diskriminoni menaxhimin e kontratave publike, se së pari nuk i besoni vetës pastaj edhe menaxhimin të kontratave publie, nese një operator oferton me një inxhinier potencial dhe plotëson kushtet e kerkeses nr 2 këtë rast, cila është arsyeja e nevojës së noterizimit dokumenteve, ku prap një operator ekonomik për arsye të nevojave subjektive duhet ta ndrroj këtë këtë pjesë të stafit, atëher zëvendësimi i një inxhinieri tjetër potencial duhet të plotësoj kushtet e dosjes së tenderit (kërkeses në fjal) dhe të aprovohet zëvendësimi nga menaxheri kontratës nga autoriteti kontraktues. E jo si standart qe e keni as nuk e dinë se me cfar stafi ka ofertu një operator ekonomik” .

Pretendimi 2 – “3.Udhëheqës i punishtes - Inxhinier i diplomuar(ose Master) I ndërtimtarisë-konstruktiv apo ne fushen e infrastruktures rrugore - me se paku 10 vite përvojë pune pas diplomimit. Të ketë menaxhuar projekte ne fushen e ndertimit ne vlere min 4 milion euro. . CV e nenshkruar nga vete inxhinieri, diploma e noterizuar , kontrata e punës me ofertuesin (kopje e noterizuar ne prezence te punëdhënësit dhe punëmarrësit). Nje liste me kontratat e menaxhuara nga inxhinieri ne vlere min 4 milion euro. E njëjta pjesë diskriminuese, 10 vjet përvoj pune, dhe kërkohet me vlerë, noterizimi i dokumentacioneve e panevojshme, ju duhet të përcillni menaxhimin e kontratave publike, pra të heqen vlerat dhe noterizimet, nuk ju duhet regjim policor e ku e di me marreveshje noteriale qe me qene ky inxhinier potencial në punishte, mirpo menaxhimi i mrvëfillt i kontratave, dhe kaqë e theshtë është” .

Pretendimi 3 - “Kërkesa dosjes tenderit, 9.1 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, 14. Operatori duhet të deshmoj se sistemi menaxhues i ofertuesit permbush kriteret e percaktuara ne fushen e ndertimtaris se pako per keto ISO standard: -ISO 9001 2015 -QMS ISO 9001-2015 (Internal Auditor) -ISO 14001-2015 –EMS ISO 14001-2015 (Internal Auditor) -ISO 45001-2018 -DS CEN TR 15128-2005 -EN SIO 1452-1 2009 -EN ISO 50001-2018 -EN ISO 39001-2012 Kjo është një kërkes sa diskriminuese, sa përcakton një kompani eventuale, gjithëashtu një shpenzim i panevojshë i operatorve ekonomik” .

Fillimisht duhet cekur se përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specififikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe paralogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specififikimet, termat e referencës, paramasat, paralogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga njësia kërkuese. Për këto arsye është refuzuar si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit.

Lidhur me pretendimin e parë dhe të dytë ankimor të parashtruesit, AK përmes njësisë kërkuese ka përcaktuar kërkesat e domosdoshme për të garantuar angazhimin e stafit të duhur profesional si dhe kërkesave tjera të nevojshme teknike dhe profesionale për të siguruar ekzekutimin efikas dhe efektiv të kontratës që synohet të lidhet përmes këtij aktiviteti të prokurimit. Vlen të theksohet se aktiviteti në fjalë i prokurimit ka një rëndësi mjaft të madhe për Kryeqytetin dhe banorët e saj në përgjithësi. Në anën tjetër as parashtruesi nuk ka prezantuar ndonjë argument të ligjshëm sipas të cilit do të mund të argumentoj se AK nuk ka nevojë për të parashtruar kërkesat e domosdoshme për të garantuar angazhimin e stafit të duhur profesional. Prandaj pretendimet ankimore janë të pabazuara.

Lidhur me pretendimin e tretë ankimor të parashtruesit, AK përmes njësisë kërkuese ka përcaktuar kërkesat e domosdoshme për të garantuar sigurimin e cilësisë së punimeve në kuptim të nenit 70 të LPP. Vlen të theksohet se aktiviteti në fjalë i prokurimit ka një rëndësi mjaft të madhe për Kryeqytetin dhe banorët e saj në përgjithësi. Në anën tjetër as parashtruesi nuk ka prezantuar ndonjë argument të ligjshëm sipas të cilit do të mund të argumentoj se AK nuk ka nevojë për të parashtruar kërkesa për sigurimin e cilësisë sipas nenit 70 të LPP. Prandaj pretendimi ankimor është i pabazuar.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 12.08.2024

Visar SHEHU



Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimin të këtij vendimi.